



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOVOVA**  
**KUVENDI I KOMUNËS – SKUPSTINA OPSTINE**  
**VUSHTRRI –VUCITRN**

---



Bazuar në nenin 12.2 “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 31 të Statutit të Komunës si dhe duke u bazuar në propozimin e grupit parlamentar të AAK-së përkatësisht kryetarit të këtij grupi të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 29.07.2010 miraton këtë:

**DEKLARATË**

1. Kuvendi i Komunës në Vushtrri shprehë shqetësim dhe kundërshton vendimin e Tribunalit të Hagës për rigjykim të pjesshëm të z. Ramush Haradinaj, Kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.
2. Kuvendi i Komunës konsideron se ky vendim është i padrejtë kur dihet se Tribunali me vendim unanim, me datën 03.04.2008 z. Haradinaj e kishte liruar nga të gjitha pikat e akt-akuzës dhe e kishte shpallur të pafajshëm.
3. Kuvendi, kërkon publikisht nga institucionet kompetente qendrore vendore dhe ndërkombëtare që të ndërmarrin masat e mundshme për mbrojtje në liri të z. Haradinaj.
4. Duke besuar në pafajësinë e plotë të z. Haradinaj të dëshmuar sikurse edhe në rastin e parë që u shpall plotësisht i pafajshëm nga Triunali i Hagës, kuvendi beson se edhe në këtë rast drejtësia do të triumfoj, kur dihet se e gjithë puna dhe veprimtaria e tij gjatë luftës në Kosovë ishte në frymën e luftës së drejtë të UÇK-së për çlirimin një herë e përgjithmonë të Kosovës nga Serbia.
5. Deklarata iu dërgohet mjeteve të informimit publik.

Kryesuesi i Kuvendit  
**Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI - SKUPSTINA  
OPSTINE VUCITRN**



Në bazë të nenit 12.2, "d" dhe 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, 31.2 "c" 58 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë si dhe duke u bazuar në Memorandumin e mirëkuptimit në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Sindikatës së Shërbimit Civil të Kosovës, Sindikatës së Administratës Publike, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 29.07.2010 merr këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1.**

Nga buxheti i komunës, lejohen mjete financiare në vlerë prej 2 (dy) Euro në ditë, përkatësisht 44 (katërdhjetëkatëreuro) në muaj, për pagesë të shujtës për shërbyesit civil të administratës së komunës, duke filluar nga data 01.04.2010.

**Neni 2.**

Pagesa e mjeteve të cekura si në nenin paraprak, të bëhet nga të hyrat vetanake të buxhetit të komunës.

**Neni 3.**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Vushtrri.

**Neni 4.**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit në mbledhje të kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit  
Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI - SKUPSTINA  
OPSTINE VUCITRN**



Bazuar në nenin 12.2, “d” dhe 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 31.2 “c” dhe 58 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 29.07. 2010 merr këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1.**

Lejohet ridestinimi i mjeteve të lira të buxhetit të komunës për vitin 2010, të mbetura nga projektet e realizuara kapitale – ndërtimi i infrastruktures rrugore, nga kodi 81153 në kodin 31149 projekti për renovimin e objektit të komunës. Vlera e mjeteve të ridestinuara është; 36.124.00 €.

**Neni 2.**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**Neni 3.**

Ky vendim hyn në fuqi dhe do të zbatohet nga dita e miratimit në mbledhje të kuvendit dhe nënshkrimit të të njëjtit.

**Kryesuesi i Kuvendit  
Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI - SKUPSTINA  
OPSTINE VUCITRN**

---



Bazuar në nenin 12.2, “d” dhe 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 31.2 “c” dhe 58 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 29.07. 2010 merr këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1.**

Lejohet ridestinimi i mjeteve të lira të buxhetit të komunës të vitit 2010, të mbetura nga projektet e realizuara kapitale në shumë prej 86.000.00 €. Këto mjete të ridestinuara do të shfrytëzohen për vazhdimin e asfaltimit të rrugës Vushtrri – Dobërllukë.

**Neni 2.**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**Neni 3.**

Ky vendim hyn në fuqi dhe do të zbatohet nga dita e miratimit në mbledhje të kuvendit dhe nënshkrimit të të njëjtit.

**Kryesuesi i Kuvendit  
Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI - SKUPSTINA  
OPSTINE VUCITRN**

---



Bazuar në nenin 12.2, “d” dhe 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 31.2 “c” dhe 58 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 29.07. 2010 merr këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1.**

Lejohet ridestnimi i mjeteve të buxhetit të komunës në shumë prej 9.800.00 € nga projekti “ndërtimi i infrastrukturës rrugore dhe trotuareve” përkatësisht nga programi buxhetor - planifikimi urban dhe mjedisi, në projektin “furnizimi me orendi për zyrën e kryetarit të komunës”. Këto mjete barten në programin buxhetor të zyrës së kryetarit.

**Neni 2.**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**Neni 3.**

Ky vendim hyn në fuqi dhe do të zbatohet nga dita e miratimit në mbledhje të kuvendit dhe nënshkrimit të të njëjtit.

**Kryesuesi i Kuvendit  
Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI – SKUPSTINA**  
**OPSTINE VUCITRN**



Në bazë të nenit 40, paragrafi 40.2 “a” dhe “g” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 31, paragrafi 31.2, “a” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë , Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më 29.07.2010 mori këtë:

**V E N D I M**

Për plotësim dhe ndryshim të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale

**Neni 1.**

Me këtë vendim plotësohet dhe ndryshohet Rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01Nr.742/08, dt. 30.12.2008.

**Neni 2.**

Nenit 36, i shtohet paragrafi 36.1, me këtë përmbajtje:

Nga pagesa për shërbimet e kryera: për certifikatë mbi të drejtat e pronës së paluajtshme (fletë poseduese), kopje të planit, certifikata dhe vërtetime lirohen:

- a). Familjet e dëshmorëve të Luftës së UÇK-së, Invalidët e luftës së UÇK-së Veteranët e luftës së UÇK-së si dhe familjet dhe individët përfitues të ndihmave sociale.
- b). Lirimi nga pagesa e taksës komunale nga pika “a” do të bëhet pasi që pala-kërkuesi ta prezantoi dëshminë mbi statusin përkatës.

**Neni 3.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër.

**Neni 4.**

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit në mbledhje të kuvendit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i KK-së.

Kryesuesi i Kuvendit  
**Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI - SKUPSTINA  
OPSTINE VUCITRN**



Në bazë të nenit 1 dhe 15 të Ligjit për qarkullimin e pasurisë së paluajtshme "G.Z" të Kosovës nr. 45/81, 29/86, 28/88 dhe, nenit 14.1, 14.2 dhe 17 nën "c" të ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 si dhe nenit 31.2, "n" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më 29.07.2010 mori këtë:

**V E N D I M**

Për ndërrimin e patundshmërive

**Neni 1.**

Me këtë vendim lejohet ndërrimi i patundshmërive në mes Komunës së Vushtrrisë në njërin anë dhe Izet Krasniqi nga Vushtrria në anën tjetër.

**Neni 2.**

Komuna e Vushtrrisë si pronare e ngastrës kadastrale nr.939-2, me fletë poseduese nr. 45, ZK-le Vushtrri, me sipërfaqe prej 0.02.38 ha, bënë ndërrimin e kësaj ngastrë kadastrale, si dhe të një pjese të ngastrës kadastrale nr.1121, fleta poseduese nr.1534, në sipërfaqe prej 0.01.19 ha (**sipërfaqja e përgjithshme 0.03.57 ha**), me ngastrën kadastrale nr.937-1, fleta poseduese nr.3402, ZK-le Vushtrri, me **sipërfaqe prej 0.03.57 ha**, pronë e Izet Krasniqit nga Vushtrria.

Ndërrimi i patundshmërive të cekura në paragrafin 1 të këtij neni është paraqitur në formë të skicuar në kopje të planit e cila është bashkangjitur në shtojcë dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në kuadër të kompetencave ligjore në fuqi.

**Neni 4**

Ky Vendim hynë në fuqi në ditën e aprovimit në mbledhje të Kuvendit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i KK-së.

Kryesuesi i Kuvendit  
**Ferit Idrizi**